



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 5005 / Prot.
10

Tiranë, më 21 / 12 / 2020

URDHËR

Nr. 680, datë 21.12.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN 615, DATË 9.11.2020 “PËR
MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE, FAST FOOD DHE LOKALEVE”
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 7, pika 4 gërma b të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik si dhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 5005/8, datë 21.12.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 615, datë 9.11.2020 “Për mbylljen e bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e Urdhrit rifomulohet si vijon:

“Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët në të gjithë vendin, nga ora 20:30 deri në orën 06:00 duke filluar nga datë 24.12.2020 deri në datë 04.01.2021.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, dhe fillon efektet më datë 24.12.2020. Pas datës 04.01.2021 kufizimi i aktivitetit të bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët në të gjithë vendin do të jetë në fashën orare nga ora 22:00 deri në orën 06:00 deri në një urdhër të dytë.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu